



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 4, datë 28.01.2022

PËR

MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR. 1 & 3 DHE RRUGA "AHMET DAKLI ", PALLATET NR. 15 & 23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019", I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit nr. 471/9 prot., datë 26.01.2022 si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, L.17, rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019" i ndryshuar.
2. Miratimin e disa shtesave të subjekteve përfituese në Aneksin nr.1 "Subjektet përfituese të 4 pallateve, Lagja nr.17", të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
101	SKËNDER PASHA + BUKURIJE PASHA	5 (2+2+1)	3+1
102	ALFRED ÇIFLIKU + IRMA ÇIFLIKU	3	2+1
103	HEKURAN GJOCI	2	1+1
104	MINERVE METANI	1	1+1
105	ZAIM ZOTKA, SHERIFE ZOTKA	2	1+1
106	AGRON TAFARUCI	5	3+1
107	ALTIN GJYZELI	5	3+1

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).


**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 31.01.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 92 /prot.  
11

Durrës, më 07.02.2022



**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.4 datë 28.01.2022: "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, L.17, rruga "Lura", pallatet nr.1 dhe 3 dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15 dhe 23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", i ndryshuar

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

